


A është hakuar llogaria juaj e mediave sociale?




Këto janë disa shenja:



- Nuk mund të aksesoni dot llogarinë tuaj
- Merrni një mesazh i cili tregon se fjalëkalimi i llogarisë suaj është ndryshuar, por nuk e keni ndryshuar ju
- Shikoni postime që nuk i keni bërë ju
- Papritmas po ndiqni shumë njerëz që nuk i njihni
- Shihni aksesim të llogarisë nga lokacione të pazakonta
- Ju merrni shumë reklama dyshuese.


Çfarë mund të ndodhë?

Pasoja që mund të keni nëse llogaria juaj sulmohet varen nga sasia e informacionit personal që ndani si për shembull data juaj e lindjes, adresa, emrat e anëtarëve të familjes etj. Informacioni juaj mund të përdoret për të hyrë në llogaritë tuaja të tjera ose për të vjedhur identitetin tuaj.



Çfarë duhet të bëni?

Nëse ende keni akses në llogarinë tuaj:



- **Ndryshoni fjalëkalimin**. Sulmuesi mund të ketë fjalëkalimin tuaj, kështu që ndryshojeni atë në një fjalëkalim të fortë me të paktën 15 karaktere, duke përfshirë shkronja të mëdha dhe të vogla, numra dhe simbole.
- Një **passphrase** mund të jetë më e lehtë për t'u mbajtur mend. Kjo mund të jetë një fjali që përfshin fjalë të pazakonta ose fjalë nga gjuhë të ndryshme.
- Ju gjithashtu duhet të ndryshoni **detajet e hyrjes** për ndonjë nga llogaritë tuaja të tjera që përdorin të njëjtin ose të ngjashëm emër përdoruesi dhe fjalëkalim. Kjo përfshin aplikacione të lidhura me llogarinë e mediave sociale.
- Përdorni një **fjalëkalim unik** për çdo llogari.
- Bëni llogarinë tuaj më të sigurt. **Shikoni cilësimet e sigurisë dhe të privatësisë** ku mund të gjeni mjete për të mbrojtur llogarinë tuaj.

Nëse nuk jeni në gjendje të aksesoni llogarinë tuaj:

- Ndiqni **procesin e rikuperimit** të llogarisë nëse jeni plotësisht i bllokuar. Të gjithë ofruesit kryesorë kanë një proces për të rikuperuar llogarinë tuaj.



Këshilla:

- **Njoftoni ofruesin e shërbimit** që llogaria juaj është hakuar. Kjo do të ndihmojë ofruesin të gjurmojë mashtrimet dhe të përmirësojë sigurinë.
- **Raportoni sulmin**. Informacioni juaj mund të ndihmojë në kapjen e sulmuesit dhe në parandalimin e incidenteve të mëtejshme.
- **Tregojuni kontakteve** tuaja se llogaria juaj është hakuar. Kontaktet tuaja mund të marrin mesazhe ose të shohin postime të dërguara nga llogaria juaj, të cilat përmbajnë linke keqdashëse ose informacione mashtruese. Njoftoni se nuk keni qenë ju që keni postuar ose dërguar mesazhet në mënyrë që ata të mos klikojnë në asnjë link.
- **Ndani përvojën** tuaj me familjen dhe miqtë për të ndihmuar në mbrojtjen e tyre.

